**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier**

**Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve për Periudhën: 01 Janar 2023 – 31 Dhjetor 2023**

| **Nr. Rendor** | **Data e kërkesës** | **Objekti i kërkesës** | **Data e përgjigjes** | **Përgjigje** | **Mënyra e përfundimit të kërkesës** | **Tarifa** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Numri Rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve | Data e regjistrimit të kërkesës | Përmbledhje e objektit të kërkesës, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Data e kthimit të përgjigjes | Përmbajtja e përgjigjes, duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi | Përgjigja jepet: E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/ E deleguar | Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuara nga autoriteti publik |
| 1. | Kërkesë për informacion dërguar me Shkresë më datë 20.01.2023 | Kërkesë për informacion/sqarim nga Znj. (…) në lidhje me një kërkesë penale të paraqitur prej saj pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe që i është kthyer mbrapsh nga ana e gjykatës. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 20.01.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.373 Prot., datë 20.01.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 01, datë 20.01.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: "Nga verifikimi i kryer pranë Arkivës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, rezulton se kërkesa penale që i përket palës kërkuese: (…), Tiranë, me objekt: *"Kundërshtim i vendimit të prokurores* (…)*"*, është protokolluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me nr. 265 | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Prot., datë 17.01.2023. Nga komunikimi me arkivisten e gjykatës, më bëhet me dije se kërkesa Juaj drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier Ju është kthyer mbrapsh nëpërmjet shërbimit postar po në datën 17.01.2023, me siglimin e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (…), për arsye se kërkesës nuk i është bashkangjitur fotokopjo e dokumentit Tuaj të identifikimit si karta e identitetit (ID), apo pasaportë. Ju mund ta paraqisni kërkesën Tuaj përsëri në gjykatë, duke i bashkangjitur fotokopjo të dokumentit Tuaj të identifikimit". Bashkangjitur, po Ju vëmë në dispozicion kopjo të fletës së regjistrit të protokollit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, të skanuar. | | |
| 2. | Kërkesë për informacion dërguar me Shkresë më datë 31.01.2023 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Z.B.B, në cilësinë e palës paditëse, në lidhje me mundësinë e tërheqjes së kopjes se njehsuar me origjinalin të akteve shkresore të dosjes civile e cila është | Kthim përgjigje me shkresë më datë 03.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.618 Prot., datë 31.01.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 02, datë 31.01.2023, përcjellë për trajtim nga Zv/Kryetarja e Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (…). Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Procesverbalin e çështjes civile me Nr. (…)-(…)-62-2020, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), si dhe Procesverbalin Audio (CD)". Ju informojmë se, nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nga gjyqtarja Znj. (…), ka përfunduar së shqyrtuari: "*Faza e Parë e Pjestimit të Pasurisë*", që i përket çështjes civile me Nr. (…)-(…)-62-2020 Regj. Them., datë 04/11/2020 Regjistrimi, me palë paditëse: M.M. dhe Të Tjerë, palë të paditura: M.B. dhe Të Tjerë, me objekt: "*Pjestim pasurie ne bashkepronesi te dy siperfaqeve toke are*". Nga ana e K/Sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier do t'Ju vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore dhe jeni të lutur të paraqiteni në sportelin e K/Sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për të tërhequr aktet shkresore të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dosjes civile të sipërcituar. Gjithashtu, nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier po Ju vihet në dispozicion edhe procesverbali audio (CD) i seancave gjyqësore, me qëllim verifikimin e provave shkresore të paraqitura nga palët në këtë gjykim, me provat shkresore të cilat janë administruar nga ana e gjykatës. Na lejoni t'Ju informojmë se, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton se gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve, i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave, ose të gjyqtarëve, passjell përgjegjësi sipas ligjit. Dhënia e drejtësisë duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj ndikimi, ndërhyrjeje të subjekteve publike ose private. Pavarësia e gjyqësorit mbështetet edhe në nenin 4, Pika 3 dhe 6 të Ligjit nr.98/2016 "Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku parashikohet se: "3. *Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm".. 6. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit*". *Në shtetin e së* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor është ankimi në një gjykatë më të lartë, sipas legjislacionit në fuqi.* Ju bëjmë me dije se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.618 Prot., datë 31.01.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 02, datë 31.01.2023, iu vu në dispozicion Zv/Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….), si dhe gjyqtares që ka shqyrtuar çështjen, Znj. (….). | | |
| 3. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 31.01.2023 | Kërkesë për informacion nga Av.F.B., si përfaqësuese e palëve paditëse, në lidhje me planifikimin dhe ecurinë e shqyrtimit për dy çështje civile të depozituara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me<br>E-mail<br>më datë 02.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.678 Prot., datë 31.01.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 03, datë 01.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion dhe skedulin e çështjeve civile me Nr. (….)-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 2. Informacion dhe skedulin e çështjeve civile me Nr. (….)-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS) ". Ju informoj se për të dyja çështjet civile deri në ditën e sotme, nuk është planifikuar seanca e parë e veprimeve të pajtimit nga ana e gjyqtarëve përkatës, të cilëve u kanë rënë për shqyrtim çështjet. *Së pari;* Në lidhje me kërkesë-padinë e paditësit (….), gjyqtarja e ka konstatuar padinë me te meta dhe pasi janë plotësuar të metat e kërkesë-padisë nga ana e palës paditëse, i është dërguar njoftim dhe komunikim i kërkesë-padisë dhe provave shkresore palës së paditur, me qëllim për t'i dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë deklaratën e mbrojtjes dhe provat. Deri në këto momente, gjykata është në pritje të konfirmimit të njoftimit të palës së paditur. Së dyti; Në lidhje me kërkesë-padinë e paraqitur nga paditësja (….), gjykata i ka dërguar njoftim me qëllim komunikimin e kërkesë-padisë dhe provave shkresore palës së paditur, i cili është shtetas rumun, me qëllim për t'i dhënë mundësi palës së paditur të paraqesë deklaratën e mbrojtjes dhe prova. Paditësja personalisht e ka | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | konfirmuar faktin se i ka shkuar njoftimi palës së paditur dhe deri në këto momente, gjykata është në pritje të ardhjes se njoftimit të palës së paditur në gjykatë | | |
| 4. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 01.02.2023 | Kërkesë për informacion nga Z.S.K., në cilësinë e viktimës, në lidhje me planifikimin e një çështje penale, që është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 02.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.679 Prot., datë 01.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 04, datë 01.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion dhe skedulin e çështjes penale me Nr. 520005-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Kjo çështje po shqyrtohet nga gjyqtari (….) dhe seanca gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….).02.2023, ora (….). | E plotë | Falas |
| 5. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 03.02.2023 | Kërkesë për informacion nga Av.L.Xh, si përfaqësues me prokurë i palës paditëse G.M., në lidhje me ecurinë e | Kthim përgjigje me E-mail më datë 07.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.748 Prot., datë 03.02.2023, për dhënie | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | një kërkesë-padie të depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | informacioni, rregjistruar me numër rendor 05, datë 03.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacionin që i përket çështjes civile me Nr. (….)-(….)-62-2022 që po shqyrtohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)”. Ju informoj se, nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS ), rezulton se kjo çështje civile po shqyrtohet nga gjyqtari, Z. (….). Në lidhje me ecurinë e gjykimit, bëj me dije se gjykata i ka komunikuar kërkesë-padinë dhe aktet shkresore palës së paditur. I është lënë kohë palës së paditur të paraqesë deklaratën e mbrojtjes dhe aktet shkresore në mbështetje të saj. Nga komunikimi me gjyqtarin që ka në shqyrtim këtë çështje, rezulton se pala e paditur nuk e ka paraqitur deklaratën e mbrojtjes brenda afatit të caktuar nga gjykata. Gjykata do të caktojë datën dhe orën e seancës përgatitore, datë e cila do t’Ju komunikohet nga ana e gjykatës me fletë-thirrje në adresën Tuaj. | | |
| 6. | Kërkesë për informacion | Kërkesë për informacion nga | Kthim përgjigje me | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dërguar me E-mail më datë 03.02.2023 | gazetari Z.I.M, i "ORA NEWS" TV, në lidhje me çështjet e dhunës në familje të regjistruara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe urdhërat e mbrojtjes të lëshuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për vitin 2022. | E-mail më datë 09.02.2023 | Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.753 Prot., datë 03.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 06, datë 03.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore penale *të regjistruara dhe të përfunduara* në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për veprën penale të "*Dhunës në familje*", të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022. 2. Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore civile me objekt: "*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*" dhe "*Lëshim urdhëri mbrojtje*", të përfunduara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, si më poshtë cituar: - Për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 janë regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale të "*Dhunës në familje*", të parashikuar nga neni 130/a të K.Penal, 62 çështje të reja, ndërkohë që 17 kanë qenë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | çështje të mbartura (të papërfunduara nga viti i mëparshëm), gjithsej për tu gjykuar 79 çështje. Nga këto kanë përfunduar së shqyrtuari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier 61 çështje penale për veprën penale të "*Dhunës në familje*". Për 59 çështje të përfunduara janë dhënë vendim fajësie dhe për 2 janë dhënë vendim pafajësie. - Për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 janë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier gjithsej 165 kërkesa me objekt: *"Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes"* dhe 110 kërkesa kanë qenë me objekt: "*Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*". Në total kanë përfunduar së shqyrtuari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier 275 kërkesa. Për 169 kërkesa është vendosur: "Pranimi i kërkesës", për 55 kërkesa është vendosur: "Pushimi i gjykimit" dhe për 51 kërkesa është vendosur: "Rrëzimi i kërkesës". *Bashkangjitur këtij e-maili, po Ju dërgojmë tabelat me të dhënat statistikore civile dhe penale (me ngjyrë të verdhë tek tabela) të raportuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022. Statistikat që po Ju vihen në dispozicion, janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.* Për çdo paqartësi që mund të hasni, mos hezitoni të na kontaktoni. | | |
| 7. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 10.02.2023 | Kërkesë për informacion nga gazetarja Znj. J.Z., e "BIRN" Albania, në lidhje me vendimet gjyqësore që janë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier në ngarkim të shtetases (….), si dhe çështjet të cilat janë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në ngarkim të shtetases së sipërcituar. Gjithashtu, kërkon leje nga gjykata për regjistrim të pjesshëm video të seancës që po zhvillohet pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndaj shtetases (….), me | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.899 Prot., datë 10.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 07, datë 10.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Vendimin gjyqësor civil me Nr. 62-2020-(….) Vendimi, datë (….)(….).2021 Vendimi, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: *"Zgjidhje martese, etj.",* të nxjerrë nga linku www.gjykata.gov.al. 2. Vendimin gjyqësor civil me Nr. 62-2022-(….) Vendimi, datë (….).(….).2022 Vendimi, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: *"Ndryshimi i vendimit të formës s ë prerë nr. (….), datë (….), etj.",* nxjerrë nga linku www.gjykata.gov.al. 3. Informacion dhe skedulin e | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kryesuese seance gjyqtaren (….). | | çështjes civile me objekt: “*Ndryshimin e vendimit nr.* (….) *dt.* (….) *te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier; etj*” me Nr. (….)-(….)-62-2022, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS). 4. Informacion dhe skedulin e kërkesë penale me objekt: “*Kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq*” me Nr. 520005-(….)-62-2023, të nxjerrë nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)”. Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se ndaj shtetases (….) janë dhënë dy vendime gjyqësore civile nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, një me objekt: “*Zgjidhje martese*” dhe tjetri me objekt: “*Ndryshimi i vendimit të formës s ë prerë nr.* (….)*, datë* (….)*, etj.”*. Në vendimin gjyqësor civil me objekt: “*Ndryshimi i vendimit të formës s ë prerë nr.* (….)*, datë* (….)*, etj.”*, gjykata ka vendosur: “Kthimin e akteve”. Më lejoni t’Ju bëj me dije | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | se, vendimi gjyqësor përmban të dhëna në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika "1" dhe nenin 5 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor. Vendimet gjyqësore të anonimizuara shkarkohen nga portali www.gjykata.gov.al/gjykatafier.<br>Për më tepër, konstatojmë se në vendimet gjyqësore gjykata shprehet edhe në lidhje me interesin e fëmijëve të mitur. Vendimet gjyqësore civile që po Ju vihen në dispozicion përmbajnë të dhëna që mbrohen nga ligji Nr.18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës". Në nenin 29 të ligjit të sipërcituar sanksionohet detyrimi që: *"Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike".* Aktualisht, është duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kërkesa penale e paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *"Dërgimin në gjyq të procedimit penal në ngarkim të të pandehurës (….)"*. Kjo çështje po shqyrtohet nga gjyqtarja Znj. (….) dhe seanca gjyqësore është planifikuar të zhvillohet në datën (….)/(….)/2023, ora 09:00. Gjithashtu, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është duke u shqyrtuar çështja civile me Nr. (….)-(….)-62-2022 Regj.Them., me objekt: "*Ndryshimin e vendimit nr.* (….) *dt.* (….) *te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier; etj*", çështje e cila po shqyrtohet nga gjyqtarja Znj. (….). Seanca gjyqësore për këtë çështje është planifikuar të zhvillohet në datën (….)/(….)/2023, ora 10:30. Përsa i përket kërkesës Tuaj, për dhënien e lejes nga ana e Kryesueses së Seancës, gjyqtarja Znj.(….) për regjistrimin video/audio të seancës së sipërcituar, bëj me dije se seanca e planifikuar është seancë paraprake dhe zhvillohet vetëm në prani të palëve. Procesverbali gjyqësor audio përmban të dhëna në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika "1" dhe nenin 5 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Referuar nenit 17, pika 1, gërma | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | “a” të Ligjit nr.119/2014, “*Për të drejtën e Informimit*”, përcaktohet se e drejta për informim mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: ***“të drejtën për një jetë private”***. Kjo e drejtë nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës, ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Në Nenin 35, pika 2 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet detyrimi që: ***“Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj”.*** Na lejoni t’Ju informojmë se, në të gjitha sallat e gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier janë të instaluara kamera sigurie dhe të gjitha seancat gjyqësore që zhvillohen në sallat e gjykimit janë me regjistrimi audio të seancës gjyqësore. Ndodhur në këto kushte, në respektim të rregullave të solemnitetit të gjykimit, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | respektimit të privatësisë së palëve në proces, të prezumimit të pafajësisë, Kryesuesja e Seancës, Znj. (….), duke marrë në konsideratë faktin se seanca e planifikuar të zhvillohet në datën (….)/(….)/2023, ora 09:00, është seancë paraprake dhe zhvillohet vetëm në prani të palëve; faktin se gjykata është në pamundësi reale për të marrë paraprakisht edhe mendimin e palëve në proces në lidhje me kërkesën Tuaj, vendosi që Ju nuk mund të kryeni regjistrim video, por Ju njeh të drejtën që të merrni pjesë si *"Dëgjues"* në seancë gjyqësore në kuadër të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit" nëse çështja kalon në gjykim themeli, pasi ky gjykim është me dyer të hapura dhe Ju mund të merrni pjesë në seancë duke sjellë në vëmëndjen Tuaj respektimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi. Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar. | | |
| 8. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 14.02.2023 | Kërkesë për informacion nga gazetarja Znj. F.S., e "BIRN" Albania, në lidhje me vendimet | Kthim përgjigje me E-mail më datë 20.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | gjyqësore që janë dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, për veprat penale *"Sjellje të dhunshme në aktivitetet sportive",* si dhe *"Tubimet publike"* . | | Informimit", kërkesën Tuaj nr.990 Prot., datë 14.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 08, datë 14.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Vendimin gjyqësor penal me Nr. 62-2018-5015 (695) Vendimi, datë 09/10/2018 Vendimi, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: *"Dërgim i çështjes në gjyq dhe kërkesë për pushimin e ndjekjes penale"* të nxjerrë nga linku www.gjykata.gov.al". Vendimi i sipërcituar është i vitit 2018 dhe ka të bëjë me procedimin penal nr.106 në ngarkim të shtetasve Z.D., E.J., B.B., A.B. dhe V.B., si të dyshuar për kryerjen e veprave penale: "*Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik*" dhe "*Organizimi dhe pjesmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme*", të parashikuara respektivisht nga nenet 236/2 dhe 262/1 të Kodit Penal. Shtetasit e sipërpërmendur dhe banorë të tjerë të zonës përreth, janë grumbulluar për të kundërshtuar ndërtimin e impiantit të përpunimit të mbeturinave, që po ndërtohej në vendin e quajtur "Landfilli në ndërtim", me | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | vendodhje midis fshatrave Verri dhe Kallm të Njësisë Administrative Mbrostar Ura, të bashkisë Fier. Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nuk rezulton të jetë shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndonjë çështje penale, për veprat penale të parashikuara nga Neni 262 i Kodit Penal *"Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme",* si dhe *"Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv"* të parashikuar nga Neni 274/a të Kodit Penal dhe "*Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive"* të parashikuar nga Neni 274/b të Kodit Penal. Më lejoni t'Ju bëj me dije se, vendimi gjyqësor përmban të dhëna në përputhje me nenin 2, me nenin 3 pika "1" dhe nenin 5 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmushjen e një detyrimi të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | parashikuar ligjor. Vendimet gjyqësore të anonimizuara shkarkohen nga portali www.gjykata.gov.al/gjykatafier. Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
| 9. | Shkresë më datë 20.02.2023 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale Fier, në lidhje me çështjet gjyqësore civile që janë aktualisht duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "Zgjidhje martese". | Kthim përgjigje me shkresë më datë 20.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1093 Prot., datë 20.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 09, datë 20.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "Listën e personave që rezultojnë të jenë në proces gjyqësor civil me objekt: "*Zgjidhje martese*" pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier". | E plotë | Falas |
| 10. | Shkresë më datë 24.02.2023 | Kërkesë për informacion/dokumentacion nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, në lidhje me rastet e kërkesë-padive të paraqitura nga ana e Komisariateve të Policisë me objekt: *"Lëshim urdhëri* | Kthim përgjigje me shkresë më datë 28.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1256 Prot., datë 24.02.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 10, datë 24.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *mbrojtje”* dhe “*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*”, që janë shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, disponimin e gjykatës, si dhe informacion në lidhje me problematikat e evidentuara nga ana e gjykatës në lidhje me paraqitjen e tyre. | | Informacion/dokumentacion në lidhje me çështjet gjyqësore me objekt: “*Lëshim urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*” dhe “*Lëshim urdhëri mbrojtje*” të përfunduara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022, si më poshtë cituar: - Për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 janë shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier gjithsej 275 kërkesë-padi, nga të cilat 165 prej tyre kanë qenë me objekt: *“Lëshim i urdhërit të zakonshëm të mbrojtjes”* dhe 110 kërkesë-padi kanë qenë me objekt: “*Lëshim i urdhëri të menjëhershëm të mbrojtjes*”. Për 169 kërkesë-padi është vendosur: “Pranim i kërkesës”, për 55 kërkesa është vendosur: “Pushimi i gjykimit” dhe për 51 kërkesa është vendosur: “Rrëzim i kërkesës”. Në total nga ana e Komisariateve të Policisë janë paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier 247 kërkesë-padi”. Më lejoni t’Ju sqaroj se, këto të dhëna që po Ju vihen në dispozicion janë statistikat zyrtare të raportuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, mbështetur në ligjin nr. 9669, datë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 18.12.2006, *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* të përditësuar, udhëzimin nr. 9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre", formulari nr.1 dhe formulari nr. 2, si dhe në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr.7, datë 15.06.2021 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.9, datë 17.06.2020 "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posacme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre". Në lidhje me problematikat e evidentuara nga ana e gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier kryesisht janë: - Së pari: Shpesh ndodh që në shkresën përcjellëse të paraqitur nga ana e Komisariateve të Policisë të citohet: *“Kërkesë-padi për lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes"*, ndërkohë kërkesë-padia bashkangjitur shkresës përcjellëse ka për objekt: *“Lëshimin e urdhërit* | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | *të zakonshëm të mbrojtjes"*, ose anasjelltas; Së dyti: - Në disa raste mungon, ose nuk janë të sakta numrat e telefonit të viktimës, apo dhunuesit. Në raste të tilla na lejoni të sugjerojmë që të citohet edhe numri i telefonit i S.P.Z.-së që ka përpiluar kërkesë-padinë me qëllim evitimin e pengesave në njoftimin e palëve ndërgjyqëse; -Së treti: Do të sugjeronim që shkrimi i raporteve të vlerësimit, procesverbaleve të deklarimit, apo i provave të tjera shkresore bashkangjitur kërkesë-padisë, të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për gjykatën, dhe nëse do të jetë e mundur që këto shkresa të përpilohen me kompjuter dhe jo me shkrim dore. Bashkangjitur, po Ju dërgojmë tabelat e raportuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier për periudhën 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022. Duke Ju falenderuar paraprakisht për punën Tuaj, faleminderit për bashkëpunimin. | | |
| 11. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 27.02.2023 | Kërkesë për informacion nga emisioni "Piranjat" Abc News Al, nëse ka ndonjë çështje civile pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor | Kthim përgjigje me E-mail më datë 28.02.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1307 Prot., datë 27.02.2023, | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fier, me palë paditëse shtetasit: P.B. dhe H.B., kundër palës së paditur Shoqëria (….). | | për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 11, datë 27.02.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se: “Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), nuk rezulton të jetë regjistruar, apo të ketë përfunduar së shqyrtuari pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ndonjë çështje civile që i përket palëve: paditëse: P.B. dhe/ose H.B., kundër palës së paditur: “(….)”. Më lejoni t’Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
| 12. | Kërkesë për informacion dërguar me Shkresë më datë 06.03.2023 | Kërkesë për informacion nga Z.R.H., në lidhje me mundësinë e një takimi me Zv.Kryetaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | Kthim përgjigje me shkresë më datë 07.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.1472 Prot., datë 06.03.2023 për dhënie informacioni, përcjellë për kompetencë më datë 06.03.2023 nga ZV/Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….), rregjistruar me numër rendor 12, datë 06.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, Ju informojmë se pas verifikimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), nuk rezulton të ketë ndonjë çështje gjyqësore civile, apo penale, e cila të jetë duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Ju të jeni palë në atë gjykim. Gjithashtu, më lejoni t'Ju informoj që kërkesa Juaj drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është e shkurtër dhe e paqartë. Jeni të lutur që ta paraqisni problemin Tuaj me shkrim, pasi për shkak të angazhimeve të shumta gjyqësore dhe administrative, ZV/Kryetarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….) e ka të pamundur t'Ju presë në këtë periudhë në takim. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton se gjyqtarët janë të pavarur në ushtrimin e funksioneve, i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve dhe se ndërhyrja në veprimtarinë e gjykatave, ose të gjyqtarëve, passjell përgjegjësi sipas ligjit. Dhënia e drejtësisë duhet të jetë e çliruar nga çdo lloj ndikimi, ndërhyrjeje të subjekteve publike ose private. Në shtetin e së drejtës, mjeti ligjor për të kundërshtuar një vendim gjyqësor | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | është ankimi në një gjykatë më të lartë. Pavarësia e gjyqësorit mbështetet edhe në nenin 4, Pika 3, nenet 5 dhe 6 të Ligjit nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: “3. *Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm”. 5. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor. 6. Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit*”. Në bazë të nenit 277 e vijues të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se ndjekja penale ushtrohet nga prokurori dhe policia gjyqësore, të cilat janë organet e ngarkuara me ligj për kryerjen e veprimeve hetimore. Në rast se Ju dëshironi të denonconi një vepër penale, organi kompetent për ushtrimin e ndjekjes penale është Policia dhe Prokuroria dhe jo Gjykata. Në rast se Ju nuk zotëroni njohuritë e duhura juridike dhe nuk keni mundësi për të marrë një mbrojtës, më lejoni t’Ju sqaroj se, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ofron ndihmë juridike falas Av.R.M., me seli të zyrës: "(….)"; me adresë elektronike: (….). Ju informoj se formularët për ndihmë juridike mund t'i gjeni në çdo kohë elektronikisht në faqen zyrtare të: Ministrisë së Drejtësisë - www.drejtesia.gov.al; Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas - www.ndihmajuridike.gov.al; Facebook: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe Instagram: Drejtoriandihmësjuridikefalas.Ndihma juridike parësore mund të përfitohet edhe ONLINE: Në platformën www.juristionline.al; si dhe Përmes numrit të telefonit falas 08001010; Ju informojmë se, një kopjo e kërkesës Tuaj me nr.1472 Prot., datë 06.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 12, datë 06.03.2023, iu vu në dispozicion ZV/Kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Znj. (….). | | |
| 13. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 06.03.2023 | Kërkesë për informacion nga gazetari Z.F.Gj. i "Syri" TV, në lidhje me lirimin e shtetasit S.(R.)B. nga Gjykata | Kthim përgjigje me E-mail më datë 07.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | e Rrethit Gjyqësor Fier. | | nr.1473 Prot., datë 06.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 13, datë 06.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, më lejoni t'Ju informoj se nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), nuk rezulton që shtetasi S.(R.)B. të jetë liruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, pasi në kohën kur është liruar nuk ka qenë në I.E.V.P. Fier. Më lejoni t'Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
| 14. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 09.03.2023 | Kërkesë për informacion nga Av.K.K., si përfaqësuese e palës së paditur, në lidhje me emrin e gjyqtarit të cilit i ka rënë për shqyrtim çështja civile me palë paditëse D.Z. etj, si dhe afatin ligjor për lëshimin e deklaratës së mbrojtjes. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 09.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1555 Prot., datë 09.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 14, datë 09.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "1. Njoftimin me Nr.1916 Prot., datë 07.03.2023, përsa i përket çështjes civile me Nr. 1027 Akti, të skanuar". Ju informoj se, nga komunikimi me sekretaren | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | gjyqësore që asiston gjyqtaren (….) mu vu në dispozicion shkresa e sipërcituar të cilën po Jua dërgoj të skanuar. Gjithashtu, mu bë e ditur se kërkesë – padia, aktet shkresore dhe formulari i deklaratës së mbrojtjes, Ju janë dërguar me shkresën përcjellëse: "Njoftim". Tek kjo shkresë përcjellëse keni emrin e gjyqtarit të cilit i ka rënë për shqyrtim çështja gjyqësore, që në rasti konkret është gjyqtarja (….) dhe afatet ligjore për paraqitjen e deklaratës Tuaj të mbrojtjes dhe aktet shkresore. Ky afat është 30 ditë nga data e nesërme e marrjes dijeni nga ana Juaj të këtij njoftimi. Një kopje e shkresës "Njoftim" e nënshkruar nga ana Juaj dhe me datën që keni marrë dijeni kthehet në Gjykatë nëpërmjet shërbimit postar. | | |
| 15. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 15.03.2023 | Kërkesë për informacion nga Av.S.N., në cilësinë e mbrojtësit të viktimës O.H., në lidhje me zhvillimin e seancës gjyqësore të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit R.H., çështje e cila është | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1703 Prot., datë 15.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 15, datë 15.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: "- | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | duke u shqyrtuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | Informacion në lidhje me çështjen penale me Nr. (….)-(….)-62-2021, që i përket palës kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kundër të pandehurit: R.H.”. Ju informoj se, seanca gjyqësore e planifikuar të zhvillohet në datën (….)/03/2023, ora 14:45, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me gjyqtar Z. (….), nuk do të zhvillohet për shkak se gjyqtari Z. (….) është transferuar në një gjykatë tjetër. Dosja e sipërcituar është dorëzuar në Kryesekretari dhe do të rishortohet. Në lidhje me zhvillimin e gjykimit Ju do të njoftoheni nga gjyqtari tjetër, i cili do të marrë në shqyrtim këtë çështje. | | |
| 16. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 15.03.2023 | Kërkesë për informacion nga Z.A.H., në cilësinë e të pandehurit, në lidhje me zbardhjen e vendimit gjyqësor të çështjes penale në ngarkim të tij. | Kthim përgjigje me E-mail më datë 15.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.1733 Prot., datë 15.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 16, datë 15.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “Informacion në lidhje me çështjen penale me Nr. (….) -(….) -62-2022, që i përket palës | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kërkuese: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: “Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq kundër të pandehurit A.H.”. Kjo çështje ka mbaruar së shqyrtuari nga gjyqtari (….) me vendimin nr. 62-2023-(….), datë (….)/03/2023, por nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), si dhe nga komunikimi me gjyqtarin e çështjes, z. (….) u vura në dijeni se vendimi i sipërcituar ende nuk është zbardhur. Sapo vendimi i sipërcituar të zbardhet, do t’Ju komunikohet nga ana e K/Sekretarisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. | | |
| 17. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 23.03.2023 | Kërkesë për informacion nga Znj.J.T., në cilësinë e palës së interesuar, si përfaqësuese e shoqërisë së sigurimeve (….), në lidhje me ecurinë e çështjeve penale në ngarkim të shtetasve: L.A. etj., N.T. etj., A.B. etj. dhe A.M., pranë Gjykatës | Kthim përgjigje me E-mail më datë 27.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, kërkesën Tuaj nr.1930 Prot., datë 23.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 17, datë 23.03.2023. Pas shqyrtimit të kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion/dokumentacion në lidhje me kërkesat penale me palë kërkuese: Prokuroria pranë | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | së Rrethit Gjyqësor Fier. | | Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe palë të interesuara shtetasit: L.A. etj., N.T. etj., A.B. etj., të nxjerra nga Sistemi Informatik i Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS)". Gjithashtu, më lejoni t'Ju informoj se nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), në lidhje me shtetasin A.M., përveç kërkesës penale në fazën e hetimit paraprak me objekt: "Vleftësimin e arrestit dhe caktimin e masës së sigurimit", nuk ka të regjistruar, apo përfunduar, ndonjë kërkesë penale të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me objekt: "Pushim procedimi penal". | | |
| 18. | Kërkesë për informacion dërguar me E-mail më datë 24.03.2023 | Kërkesë për informacion nga gazetari Z.G.A., i Emisionit Investigativ "STOP" në TV Klan, në lidhje me vendimet penale të dhëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në | Kthim përgjigje me E-mail më datë 27.03.2023 | Në cilësinë e kërkuesit keni depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën Tuaj nr.1955 Prot., datë 24.03.2023, për dhënie informacioni, rregjistruar me numër rendor 18, datë 24.03.2023. Pas shqyrtimit të | E plotë | Falas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ngarkim të shtetases A.H. | | kërkesës, bashkëngjitur gjeni: “1. Informacion/dokumentacion në format elektronik dhe më konkretisht, vendimet gjyqësore penale të dhëna prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në ngarkim të shtetases A.H. në cilësinë e të pandehurës (të anonimizuara)”. Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Manaxhimit të Çështjeve Gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier (ICMIS), rezulton se shtetësja A.H. ka qenë në cilësinë e të pandehurës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe në ngarkim të saj janë dhënë tre vendime gjyqësore penale. - Vendimi gjyqësor Nr. 62-2011-(….), datë (….), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhënë nga gjyqtar (….), ku gjykata ka vendosur: “Të deklarojë të pafajshme të pandehurën A.H., për kryerjen e veprës penale të “shkeljes së barazisë në tendera, apo ankande publike”, parashikuar nga neni 258-25 te K.Penal. - Vendimi gjyqësor Nr. 62-2017-(….), datë (….), i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhënë nga gjyqtare (….), ku gjykata ka vendosur: “Të deklarojë fajtore të pandehurën A.H., për veprën | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | penale “Falsifikimi i dokumenteve” më shumë se një herë, në baze te nenit 186/2 i K. Penal”. - Vendimi gjyqësor Nr. 62-2015-(….), datë (….), të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhënë nga gjyqtar (….), ku gjykata ka vendosur: “Të deklarojë fajtore të pandehurën A.H., për veprën penale “Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarim i rremë i pasurive, interesave private të personave të zgjedhur dhe nënpunësve publik ose i cdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, në bazë të neneve 257/a/1 dhe 49 të K.Penal”. Më lejoni t’Ju shpreh mirënjohje për punën Tuaj, si dhe gadishmërinë tonë për të bashkëpunuar! | | |
